



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.5.2023

Nr: 531

Ora: 15:00

**VENDIM
PËR**

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATEVE PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË
BASHKISË RROGOZHINË, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14
MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, e pika 2, nenit 35, pika 5 dhe nenit 122 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Zona zgjedhore Bashkia Rrogozhinë ka 1 (një) zonë të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 43.

Në referim të nenit 122, pika 3 të Kodit Zgjedhor, Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, miratohet me vendim të KZAZ-së. KZAZ nr. 43 nuk ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë. Në këtë rast, veprohet në përputhje me nenin 35 pika 5 të Kodit Zgjedhor sipas të cilit, në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet brenda 24 (njëzet e katër) orëve për shqyrtim KQZ-së nga kryetari i KZAZ-së ose të paktën nga dy anëtarë, ose mund të ankimohet në KQZ nga subjekti zgjedhor i interesuar. Një kopje e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve dhe tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi, dërgohet menjëherë në KQZ, përfshirë edhe rrugët elektronike të komunikimit.

Zëvendëskryetari dhe një anëtar i KZAZ kanë sjellë informacionin për mosmiratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës Zgjedhore për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë. Në kushtet kur KZAZ nuk ka marrë vendim, çështja i kalon për vendimmarrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 18.5.2023 Nr: 531
Ora: 15:00



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Gjatë verifikimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, rezultoi se:

Në tabelat përmbledhëse janë përfshirë rezultatet e të gjitha qendrave të votimit në juridiksionin e KZAZ 43, Bashkia Rrogozhinë, Qarku Tiranë.

Nga verifikimi i kryer, tabela e rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ nr. 43, është plotësuar duke pasqyruar rezultatin e çdo kutie të numëruar dhe atë të votave të hedhura gabim.

Nuk rezulton asnjë mospërputhje ndërmjet tabelës përmbledhëse të rezultateve të zgjedhjeve dhe tabelës së rezultateve të votimit të plotësuar nga GNV.

Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, mbështetet në origjinalet e tabelave të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj Bashkie, të plotësuar nga Grupi i Numërimit të Votave.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, e pika 2, nenin 35, pika 5 dhe nenin 122 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, z. Edison Selman Memolla, të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



QARKU Tiranë
KZAZ NR 43

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE

Për kandidatët për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr
		2200/00	2200/01	2201/00	2201/01	2202/00	2203/00	2203/01	2204/00	2207/00	2207/01	2208/00	2208/01	2209/00	2209/01	2210/00	2210/01	2211/00
2	gjithsej gra	197	207	145	163	120	143	153	144	139	120	146	151	185	167	174	206	206
3	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	93	100	58	81	56	62	74	65	69	57	69	74	88	76	0	96	96
4	Fletë votimi të papërdorura	342	330	355	357	348	464	453	375	524	538	424	414	447	413	435	398	398
5	Fletë votimi të dëmtuara	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	3	3
6	Fletë votimi të gjetur në kuti	197	207	146	163	120	143	152	144	139	120	146	156	185	167	174	206	206
7	Vota të pavlefshme	11	5	3	5	0	1	2	0	2	5	3	9	4	7	1	4	4
8	Vota të vlefshme	186	201	142	158	120	142	150	144	137	115	142	147	181	160	173	202	202
8	Fletë votimi të hedhura gabim	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFESHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësi, mbiemri)	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr
		2200/00	2200/01	2201/00	2201/01	2202/00	2203/00	2203/01	2204/00	2207/00	2207/01	2208/00	2208/01	2209/00	2209/01	2210/00	2210/01	2211/00
1	Edison Selman Memolla	101	110	59	62	36	64	68	52	34	43	35	48	82	103	101	119	119
2	Shkëlqim Hamid Hoxha	85	91	83	96	84	78	82	92	103	72	107	99	78	57	72	83	83
	Gjithsej vota të vlefshme	186	201	142	158	120	142	150	144	137	115	142	147	181	160	173	202	202



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë

QARKU Tiranë
KZAZ NR 43



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë		QV nr 2232/00	QV nr 2233/00	QV nr 2234/00	QV nr 2241/00	Fl. Vot. Gabim	Totali	Totali me fjalë
	gjithsej	gra							
2	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	344	249	274	222		X X X	10510	Dhjetë mijë Pesëqind Dhjetë
3	Fletë votimi të papërdorura	175	125	123	100		X X X	4848	Katër mijë Tetëqind Dyzetë Tetë
4	Fletë votimi të dëmtuara	504	333	551	221		X X X	22543	Njëzet Dym mijë Pesëqind Dyzetë Tre
5	Fletë votimi të gjetura në kuti	0	1	0	0		X X X	16	Gjashëmbëdhjetë
6	Vota të pavlefshme	342	250	274	222		21	10533	Dhjetë mijë Pesëqind Tridhjetë Tre
7	Vota të vlefshme	15	10	5	3		2	276	Dyqind Shtatëdhjetë Gjashë
8	Fletë votimi të hedhura gabim	326	239	269	215		19	10236	Dhjetë mijë Dyqind Tridhjetë Gjashë
		1	1	0	4		X X X	21	Njëzet Një

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësi, mbiemri)	QV nr 2232/00	QV nr 2233/00	QV nr 2234/00	QV nr 2241/00	Fl. Vot. Gabim	Totali	Totali me fjalë
1	Edison Selman Memolla	170	128	131	125	13	5133	Pesë mijë Njëqind Tridhjetë Tre
2	Shkëlqim Hamid Hoxha	156	111	138	90	6	5103	Pesë mijë Njëqind Tre
	Gjithsej vota të vlefshme	326	239	269	215	19	10236	Dhjetë mijë Dyqind Tridhjetë Gjashë